



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2026

Lënda: Kriteret e vlerësimit të kandidatëve që konkurrojnë për 1 (një) vend të lirë pune si personel akademik në kategorinë “Asistent Lektor” pranë Departamentit të Moduleve Klinike në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare.

POZICIONI: “Asistent Lektor” pranë Departamentit të Moduleve Klinike në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare.

Në përputhje me neni 57, pika 2 dhe pika 3 dhe neni 64, të ligjit me nr. 80/2015, datë 22/7/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me nenin 36, pika 2 dhe nenin 29, pika 2, Statutin e UBT-së të miratuar me Urdhër nr. 586, datë 02.12.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Rregulloren e Rekrutimit të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në UBT të miratuar me Vendim Senati Akademik me nr.9, datë 23.02.2023, si dhe në konsiderim të shkresës nga Përgjegjësi i Departamentit të Moduleve Klinike me lëndë: “Kërkesë për hapjen e një vendi të lirë si personel akademik “Asistent Lektor” në lëndën “Sëmundjet e Ruminantëve” si dhe shkresës me nr. 201 prot., datë 19.01.2026, nga Dekani i FMV-së, me lëndë: “Kërkesë për hapjen e një vendi të lirë si personel akademik “Asistent Lektor”, konfirmim kriteresh vlerësimi dhe ngritje komisioni “ad-hoc”, shpallet për t’u plotësuar nga kandidatët që do të konkurrojnë, kriteret e vlerësimit si më poshtë:

I. KRITERE TË PËRGJITHESHME

I	KRITERE – ELIMINUESE
1	- Të jetë diplomuar në sistemin me kohë të plotë në: Master Shkencor në Mjekësi Veterinare (brenda dhe jashtë vendit). - Në rastet kur kandidati ka notën mesatare 10.0 ai rekrutohet pa konkurim.
2	- Të ketë notë mesatare mbi 8.00 në ciklin e studimit; Master Shkencor në Mjekësi Veterinare. - Për çdo 0.1 notë më shumë se 8.00 shtohet me 4 pikë në vlerësim. Në asnjë rast kandidati nuk duhet të ketë notë mesatare më të ulët se 7 për çdo cikël studimi. - Të jetë nën moshën 30 vjeç në momentin e aplikimit; - Nuk pranohet asnjë kandidaturë që nuk plotëson kriteret e mësipërme.

II. KRITERE TË VEÇANTA

I	KRITERE PËR VLERËSIMIN NË DOSJEN E KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
	Shkollim dhe kualifikim të mëtjshëm	
	Master jashtë vendit (brenda fushës që konkurron)	5
2	Përvojë pune	
	• Për çdo vit eksperiencë në mësimdhënie në universitet (kohë e plotë dy pikë)	2
	• Për çdo vit eksperiencë në mësimdhënie në universitet (pedagog i ftuar)	1
3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit	
	• Për kurs kualifikimi brenda vendit (të vërtetuar me dëshmi ose dokumente të tjera) nr. Kursesh*pikët për secilin.	1
	• Për kurs kualifikimi jashtë vendit (të vërtetuar me dëshmi ose dokumente të tjera), nr. Kursesh* pikët për secilin.	2
4	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht) e vërtetuar me dëshmi.	
	• Gjuhë Angleze, niveli C1	20
	• Gjuhe të tjera, niveli ekuivalent me C1 në gjuhën angleze	10
5	Aftësi në programe kompjuterike, të vërtetuara me dëshmi.	2
6	Referime në:	
	Sesione dhe konferenca shkencore dhe kongrese brenda vendit, numër pjesëmarrjesh me botim në proceedings (autor i parë)	5
	Sesione dhe konferenca shkencore dhe kongrese jashtë vendit, numër pjesëmarrjesh me botim në proceedings (autor i parë)	10
TOTALI PIKËVE TË DOSJES: (70%) e Totalit prej 100 pikësh (max 70 pikë)		
TOTALI PIKËVE NGA INTERVISTA ME GOJË: (30%) e Totalit prej 100 pikësh (max 30 pikë)		

Shënim:

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Juridike dhe Komisioni i rekrutimit bëjnë vlerësimin e dosjes sipas përcaktimeve të mësipërme.
- Diferencën e pikëve për shumen 30% kandidati e merr nga intervista.

REKTORI

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU